Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1039
Data e Vendimit: 27.12.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 dhe nenit 64 të Rregullores Nr.002/2022 për Prokurim Publik pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE "Pattern" SH.P.K- Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e tabletave për inspektor te AZHB-së" me numër të prokurimit 203-23-11410-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillimit, Rural", Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 27/12/2023, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e "Pattern" SH.P.K- Lipjan me nr. të protokollit 2023/1039, e datës 22/12/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Blerja e tabletave për inspektor te AZHB-së" me numër të prokurimit 203-23-11410-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillimit, Rural".

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillimit, Rural" që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Blerja e tabletave për inspektor te AZHB-së" me numër të prokurimit 203-23-11410-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

"Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillimit, Rural" në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 18.10.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Blerja e tabletave për inspektor te AZHB-së" me numër të 203-23-11410-1-2-1, me datën 05.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 08.12.2023 OE "Pattern" SH.P.K- Lipjan kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 11.12.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të pa bazuar.

Operatori ekonomik i pakënaqur me vendimin e AK - "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillimit, Rural" ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, përmes sistemit e-prokurimit me datën 22.12.2023

- Administrimi dhe Vlerësimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Blerja e tabletave për inspektor te AZHB-së" me numër të prokurimit 203-23-11410-1-2-1, në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK) "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillimit, Rural", ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë 05.12.2023. Ndaj këtij njoftimi është paraqitur kërkesë për rishqyrtim nga operatori ekonomik ankues me datën 08.12.2023 ndërsa me datën 11.12.2023 AK ka refuzuar kërkesë për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Meqë AK - "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillimit, Rural" me datën 11.12.2023 AK ka refuzuar kërkesë për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues, afati ligjor për të paraqitur ankesë në OSHP ka filluar të rrjedh nga data 12.12.2023 deri me datën 21.12.2023 ora 16:00.

Zyra për pranimin e ankesave pas pranimit të ankesës ka konstatuar se operatori ekonomik ankues OE "Pattern" SH.P.K- Lipjan ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 22.12.2023.

OE ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 2 të nenit 109 të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK.

Neni 109 paragrafi 2 i LPP-së përcakton se *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.*

Po ashtu, edhe neni 64.1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohen se: *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë*

nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

-Përfundimi-

Konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 22.12.2023 nga OE "Pattern" SH.P.K- Lipjan për aktivitetin e prokurimit me titull "Blerja e tabletave për inspektor te AZHB-së" me numër të prokurimit 203-23-11410-1-2-1 është e jashtafatshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesën brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 64 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë Dhe Zhvillimit, Rural" në cilësinë e autoritetit kontraktues, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Blerja e tabletave për inspektor te AZHB-së" me numër të prokurimit 203-23-11410-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen me nenin 1, 6, 7,24.2, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MIN.E BUJQËSISË,PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL**
- OE - **Pattern SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: